**URDHËR**
**Nr.336, datë 14.7.2011**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË MËSUESIT"**

Në përputhje me nenin 11 të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Duke filluar nga viti shkollor 2011-2012 të zhvillohen procedurat e organizimit dhe zhvillimit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit në përputhje me rregulloren e "Organizimit dhe zhvillimit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit".

2. Ngarkohen për hartimin e programeve të praktikës profesionale Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal në MASH.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Koordinimit Rajonal në MASH, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në MASH, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, si dhe drejtoritë arsimore rajonale e zyrat arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
**Myqerem Tafaj**